Komunikata

17/02/2026

Raporti I Ngjarjeve, 17 Shkurt 2026

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Korçë referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin E. Z., 41 vjeç, banues në fshatin Goskovë, Korçë, pasi më datë 15.02.2026, dyshohet se ka tentuar të vjedhë në arkën e një objekti kulti në fshat, një sasi parash.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Devoll referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasit:
-B. M., 36 vjeç, banues në fshatin Koshnicë, Devoll dhe K. B., 62 vjeç, banues në fshatin Poloskë, Devoll, për veprën penale "Prerja e paligjshme e pyjeve". Këta shtetas u kapën në aksin rrugor "Mirasi-Bilisht", duke transportuar me automjetet e tyre, sasi me dru zjarri, pa dokumentacionin përkatës. Sasitë e druve së bashku me dy automjetet, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për veprime të mëtejshme.

Apel për kujdes gjatë lëvizjes në rrugë.

Për shkak të reshjeve të shiut dhe të borës, është vështirësuar qarkullimi në disa akse rrugore, kryesisht në zonat malore të vendit.

Shërbimet e Policisë Rrugore dhe të Patrullave të Përgjithshme janë në terren, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe për të ndihmuar përdoruesit e rrugës, në rast nevoje.

Policia Rrugore po bashkëpunon me entet pronare të rrugëve dhe firmat kontraktore, me qëllim pastrimin dhe inertet.

Policia Rrugore apelon për drejtuesit e mjeteve që të bëjnë kujdes gjatë lëvizjes, të moderojnë shpejtësinë dhe të respektojnë me rigorozitet sinjalistikën rrugore , të pajisen me zinxhirë dhe goma dimërore dhe të ndjekin udhëzimet e shërbimeve të Policisë Rrugore .

Për rast nevoje për ndihmë, telefononi në numrin pa pagesë 112.

#Kujdesgjatëlëvizjes⁉️
#Respektoninregullatëqarkullimit

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Elbasan arrestuan në flagrancë shtetasin A. S., 37 vjeç, banues në Elbasan, pasi në kundërshtim me vendimin e Gjykatës, ka ushtruar dhunë fizike ndaj babait të tij, i cili ishte i pajisur me urdhër mbrojtjeje.

Gjithashtu, këta specialistë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin I. Gj., 42 vjeç, pasi ka bërë kallëzim të premë se në lokalin e tij, në lagjen "Beqir Dardha", i kanë vjedhur një shumë parash dhe produkte, dhe dyshohet se ka kryer veprime për inskenimin e ngjarjes. Po punohet për verifikimin e rastit.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Librazhd referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit S. M., 45 vjeç E. M., 21 vjeç, K. K., 44 vjeç, A. D., 19 vjeç, dhe I. H., 50 vjeç, pasi gjatë një konflikti fizik me njëri-tjetrin, për motive të dobëta, kanë prishur qetësinë publike.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-B. Rr., 32 vjeç, pasi në aksin rrugor "Prenjas-Librazhd", me automjetin që drejtonte ka aksidentuar shtetasen L. M., 71 vjeçe, këmbësore, e cila është në kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën;
-A. K., 18 vjeçe, pasi u kap duke drejtuar automjetin, pa leje drejtimi.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit B. I., 37 vjeç, dhe K. Z., 24 vjeç, banues në Marikaj, të cilët qarkullonin me një automjet, dyshohet me qëllim shitjen e lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit fizik, drejtuesit të automjetit, shtetasit B. I. iu gjet një sasi lëndë e dyshuar narkotike Cannabis Sativa, ndërsa gjatë kontrollit në banesën e pasagjerit, shtetasit K. Z., u gjetën dhe u sekuestruan 108 qese farmaceutike me mbetje të lëndës së dyshuar narkotike Cannabis Sativa dhe një asi e vogël municioni luftarak.

Specialistët e qarkullimit rrugor referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë për një 15-vjeçar, pasi u konstatua duke drejtuar një motorinet, pa leje drejtimi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Durrës referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. K., banues në Xhafzotaj, i dyshuar për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Stacionit të Policisë Kavajë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. S., 46 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale "Shpërndorimi i toksiks".
Gjithashtu, këta specialistë, në bashkëpunim me shërbimet e Policisë Kufitare në PKK Bllatë, kryen veprimet procedurale për kapjen dhe shoqërimin e shtetasit J. Ll., 34 vjeç, banues në Rrogozhinë, i cili ishte shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Kavajë, për veprën penale "Përndjekja". Pas konsultimin me prokurorin, u vendos që ky shtetas të ndiqet në gjendje të lirë.

Më datë 16.02.2026, është dërguar në spitalin e Durrësit, shtetasja F. T., 23 vjeçe, banuese në Sukth, e cila dyshohet se ka konsumuar Fotokisinë, në banesë. Ajo u dërgua për mjekim të specializuar në QSUT, por pavarësisht ndihmës mjekësore humbi jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme.

Policia Rrugore e Dibrës ka vijuar monitorimin intensiv në të gjitha akset rrugore të qarkut, duke përdorur radarë, automjete inteligente dhe dragera, me qëllim parandalimin e aksidenteve rrugore me pasoja dhe menaxhimin e sigurt të trafikut.

Ndër prioritetet kryesore të punës mbeten evidentimi dhe ndëshkimi i drejtimit të mjetit nën efektin e alkoolit apo në gjendje të dehur, si dhe parakalimet e gabuara, shkelje të cilat përbëjnë ndër shkaqet kryesore të aksidenteve të rëndа rrugore.

✅ Si rezultat i kontrolleve gjatë javës së fundit, janë arrestuar në flagrancë 2 shtetas që drejtonin mjetin në gjendje të dehur, ndërsa 1 tjetër është proceduar penalisht në gjendje të lirë për shkeljet të rregullave të qarkullimit rrugor.

✅ Po gjatë kësaj periudhe, janë ndëshkuar administrativisht 354 drejtues mjetesh, konkretisht:
•183 për ndalim ose pushim të automjetit në kundërshtim me sinjalistikën rrugore;
•63 për parakalime të gabuara;
•5 për tejkalim të normave të lejuara të shpejtësisë;
•20 për mosvendosjen e rripit të sigurimit;
•5 për drejtim mjeti nën efektin e alkoolit;
•11 drejtues kamionësh për tejkalim të peshës së lejuar;
•2 drejtues për xhama të errët të pahomologuar dhe pa dokumentacion përkatës;
•65 për shkeljet të tjera të Kodit Rrugor.

Policia Rrugore e Dibrës u bën apel të gjithë drejtuesve të mjeteve që të zbatojnë me korrektësi rregullat e qarkullimit rrugor, të drejtojnë mjetin me përgjegjësi dhe të shmangin çdo veprim që cenon sigurinë në rrugë, duke i bërë me dije se çdo shkelje do të konstatohet dhe do të ndëshkohet sipas parashikimeve ligjore.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Krimeve Kibernetike referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin M. P., pasi dyshohet se ka përndjekur në rrjetet sociale, një 23-vjeçare.

Specialistët për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetaset e hujaja G. G., V. U. dhe I. S., pasi dyshohet se ushtronin prostitucion në 2 apartamente të marra me qira.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit F. B., K. D. dhe L. G., për veprën penale "Mashtrimi", pasi secili prej tyre iu ka marrë shuma parash, shtetasve të ndryshëm, nëpërmjet mashtrimit.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit:
-A. D., pasi dyshohet se ka kanosur shtetasin E. K., nëpërmjet celularit;
-E. Gj., pasi dyshohet se ka kanosur shtetasin D. M., nëpërmjet një platforme komunikimi.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 arrestuan shtetasit:
-S. K., 51 vjeç; pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëshortes së tij;
-E. Q., 46 vjeç, pasi dyshohet se ka përndjekur një 36-vjeçare.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për:
-shtetasin P. N., pasi dyshohet se ka kanosur shtetasen C. P., për motive të dobëta;
-shtetasen E. Xh. dhe një shtetase të mitur, pasi dyshohet se kanë goditur një shtetase të mitur.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4:
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen F. M., pasi dyshohet se ka dhënë deklaratë të rreme para oficerit të Policisë, për vjedhjen e automjetit të saj;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasit A. M. dhe A. J., pasi dyshohet se kanë kanosur shtetasin S. M.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5, në bashkëpunim me shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2, kapën dhe ndaluan shtetasin A. H., 28 vjeç, pasi Gjykata i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Përndjekja".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin D. Gj., pasi nuk i është bindur urdhrit të punonjësit të Policisë.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 7, në bashkëpunim me Seksionin e Kërkimit të DVP Tiranë, kapën dhe ndaluan shtetasin E. C., 59 vjeç, pasi Gjykata e ka dënuar me 1 vit burgim për veprën penale "Shkatërrimi i pronës me zjarr".

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin F. T., pasi në fshatin Qerekë, në pronën e tij, u konstatua duke hedhur inerte, me qëllim ndryshimin e destinacionit të tokës.

Specialistët e qarkullimit rrugor:
-arrestuan shtetasin P. L., 41 vjeç; pasi me automjetin që drejtonte në gjendje të dehur, ka përplasur një automjet tjetër, me pasojë dëme materiale;
-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin B. Sh., pasi dyshohet se ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit, i cili ka dalë nga rruga. Si pasojë janë dëmtuar drejtuesi dhe pasagjeri në automjet, të cilët po marrin ndihmë mjekësore në spital.

-Më datë 16.02.2026, është dërguar nga familjarët, në spital, shtetasi A. R., 60 vjeç, i cili dyshohet se është dëmtuar nga pakujdesia, me gur fresibël, në banesë. Pavarësisht ndihmës mjekësore, ai ka humbur jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kukës/ Informacion paraprak

Në lagjen nr. 2, në qytetin e Kukësit, disa të mitur të moshës 15 dhe 16 vjeç, për motive të dobëta, janë konflikturar me mjete rrethanore me njëri-tjetrin. Si pasojë, ka marrë dëmtime të lehta një i mitur 15-vjeçar.

Shërbimet e Policisë kanë identifikuar 5 prej persona të mitur të dyshuar të përfshirë në konflikt, të cilët janë shoqëruar në Komisariat në prezencë të familjarëve dhe psikologes.

Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, po punon për sqarimin e rrethanave dhe dokumentimin ligjor të ngjarjes.

PKK Kakavijë

Procedohet penalisht një shtetase që tentoi të nxirrte pa deklaruar, nga Shqipëria, 34 700 euro.

Sekuestrohet shuma e eurove.

Në vijim të punës së shërbimeve të Policisë Kufitare të PKK Kakavijë, me qëllim parandalimin dhe goditjen e paligjshmërive në kufi, në dalje, u krye kontroll në çantën e shtetasesë D. B., ku u gjetën 34 700 euro, të cilat ajo nuk i kishte deklaruar konform ligjit.

Në vijim të veprimeve procedurale për rastin, specialistët për Hetimin e Krimeve të DVKM Gjirokastër referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi në gjendje të lirë, për veprën penale "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", për shtetasen D. B., banuese në Burrel. Gjithashtu, u sekuestrua me cilësinë e provës materiale, shuma e eurove.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët e Qarkullimit Rrugor të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. L., 47 vjeç, banues në Fier, pasi duke drejtuar motorsipetin pa leje drejtimi, është përplasur me një automjet me drejtuesi shtetasin E. H., 25 vjeç. Aksidenti shtetasit M. L., ndodhet në spital për ndihmë mjekësore, jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin R. S., 59 vjeç, banues në Shkodër, pasi nga verifikimet rezultoi se ushtronte aktivitetin në një subjekt për çmontimin dhe shitjen e pjesëve të automjeteve, në fshatin Bërdicë, pa e regjistruar në organet tatimore. Gjithashtu, gjatë kontrollit në subjekt, u gjetën dhe u sekuestruan 5 automjete të dyshuara të kontrabanduara nga Mbretëria e Bashkuar.

Specialistët e Sektorit të Qarkullimit Rrugor referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin H. Gj., 66 vjeç, banues në fshatin Kaç, pasi u kap duke drejtuar motorsipetin, pa leje drejtimi.

Specialistët e Policisë Rrugore referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin M. Q., 32 vjeç, banues në Elbasan, pasi më datë 15.02.2026, në përfundim të ndeshjes së futbollit ndërmjet ekipeve "KF Villaznia" dhe "AF Elbasani", në stadiumin "Loro Boriçi", kanë shkatërruar disa ndenjëse dhe i kanë hedhur në fushën e lojës. Punohet për identifikimin e shtetasave të tjerë që kanë kryer veprime të paligjshme në ambientet e stadiumit.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.
--
Malësi e Madhe/Më datë 17.02.2026, shtetasja N. H., 69 vjeçe, ka kallëzuar se mbrëmjen e djeshme, i kanë vjedhur një shumë parash prej 350 000 lekë në banesën e saj, në fshatin Polva.
Grupi hetimor po punon për identifikimin dhe kapjen e autorëve të veçhëjes.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent